



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:147113

Datë: 12.09.2019

Numri i dokumentit: 00508239

P.nr.445/2016

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Rrahman Beqiri, me procesmbajtëse Selvije Kostërci, në lëndën penale ndaj të pandehurve: Z.M., D.F. dhe R.C., sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1557/2015 të datës 01.06.2016, të pandehurit: Z.M. dhe R.C., për shkak të veprës penale: Legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 403 par.1 e lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje: KPRK), të pandehurit: Z.M. dhe D.F., për shkak të veprës penale: Legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 403 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 02.09.2019 në prezencën e Prokurorit të Shtetit Natasha Radović dhe të pandehurve, me datë 03.09.2019 publikisht shpalli, ndërsa me datë 12.09.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. Z.M., nga i ati P., e ëma A., e vajzërisë M., i lindur me datë *data e lindjes...* në ..., ku edhe jeton, Rr. “K.M.” pn/., zyrtar në zyrën lokale, i martuar, baba i ... fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal *numri personal...*, serb, shtetas i Republikës së Kosovës, nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale.

2. D.F., nga i ati Sava, e ëma M., e vajzërisë S., i lindur me datë *data e lindjes...* në ..., ku edhe jeton, Rr. “K.P.” nr...., i ve, baba i ... fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal *numri personal...*, shtetas i Republikës së Kosovës, nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale.

3. R.C., nga i ati M., e ëma M., e vajzërisë M., i lindur me datë *data e lindjes...* në fshatin Ll., komuna e ..., me vendbanim aktual në adresën, Rr. “2.”, nr...., ..., punëtor në ndërtimtari, i martuar, baba i ... fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal *numri personal...*, shtetas i Republikës së Kosovës, nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale.

I

Të akuzuarit Z.M. dhe R.C.:

JANË FAJTORË

Sepse,

Me datë 18.12.2012 kanë vënë në lajthim Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve në Mitrovicë, organin kompetent që një dokument publik ta vërtetoi për të shërbyer si provë në një çështje ligjore, ashtu që i pandehuri R.C. pas marrëveshjes me të pandehurin Z.M., së bashku kanë shkuar në QRA në Mitrovicë dhe kanë prezentuar librezën e qarkullimit të falsifikuar me CP 08987336 për automjetin e markës “Ford Galaxy” 1.9 TDI, me numë të shasië WFOGWWPSWGTR26919 me qëllim të përfitimit nga vendimi i Qeveris së Kosovës, sipas të cilit vendim, të gjitha automjetet deri me datën 15.11.2011 mund të regjistrohen nga targat KM në RKS, ashtu që arrijnë ta regjistrojnë automjetin dhe t`i marrin targat e Republikës së Kosovës *targat e regjistrimit...* dhe librezën e çarkullimit CRA 03029.. në emër të pandehurit Z.M., pastaj lidhin kontratën fikse më datë 20.01.2012 për ndërrimin e pronarit dhe marrin transferin e regjistrimit nga QKRA në Mitrovicë në QRA në Istog dhe më datë 23.01.2012 marrin targa *targat e regjistrimit...* si dhe librezën CRA 03051.. në emrin e të pandehurit R.C., e që vërtetohet nga Laboratori i kriminalistikës në Prishtinë se libreza me CP08987... është plotësisht e falsifikuar.

Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale: Legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 403 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

II

Të akuzuarit Z.M. dhe D.F.:

JANË FAJTORË

Sepse,

Më datë 01.03.2012 kanë vënë në lajthim Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve në Mitrovicë, organin kompetent që një dokument publik ta vërtetoi për të shërbyer si provë në një çështje ligjore, ashtu që të pandehurit Z.M. dhe D.F., pas marrëveshjes paraprake, së bashku kanë shkuar në QRA në Mitrovicë-Veri dhe kanë prezentuar librezën serbe të qarkullimit të falsifikuar me CP07479... për automjetin e markës “Reanult 2.2D” me vit të prodhimit 2001, me qëllim të përfitimit nga vendimi i Qeveris së Kosovës së të gjitha automjetet deri me datë 15.11.2012 mund të regjistrohen nga targat KM në RKS, ashtu që arrijnë ta regjistrojnë automjetin dhe t`i marrin targat e Republikës së Kosovës *targat e regjistrimit...* dhe atë librezën e qarkullimit në emër të pandehurit D.F., e që vërtetohet nga laboratori i kriminalistikës në Prishtinë se libreza me CP074794.. është plotësisht e falsifikuar, të cilin automjet i pandehuri D. ia shet dëshmitarit M.U., por ky automjet nuk është gjendur tek i njëjti si dhe nuk ka mund të konfiskohet.

Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale: Legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 403 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 31, 41, 42, 43, 49, 50, 51, 52, 73, 74, të KPRK-së, dhe nenit 365, 450, 463 të KPP-së, të pandehurve:

Të pandehurin Z.M., e:

G J Y K O N

Për pikën I, për veprën penale: Legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 403 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i cakton dënim me burgim të kushtezuar në kohzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryenë veprën tjetër penale

gjatë periudhës së verifikimit, në kohëzgjatje prej një (1) viti nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.

Për pikën II, për veprën penale: Legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 403 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i cakton dënim me burgim të kushtëzuar në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen veprë tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit, në kohëzgjatje prej një (1) viti nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.

Gjykata, në mbështetje të nenit 80 të KPRK-së

Të pandehurit Z.M., i:

SHQIPTON.

1. Dënim unik me burgim të kushtëzuar, në kohëzgjatje prej tetë (8) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehurit nuk kryenë veprë tjetër penale në kohëzgjatje prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të pandehurëve D.F. dhe R.C. i:

GJYKON

2. Dënim me burgim të kushtëzuar, secilit veç e veç, në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse të pandehurit nuk kryejnë veprë tjetër penale në kohëzgjatje prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
3. Në mbështetje të nenit 69 të KPRK-së dhe nenit 283 të KPP, të pandehurit R.C. i shqiptohet: Dënim plotësues -Konfiskimi i sendeve dhe atë:
 - a. Automjeti i markës “Ford Galaxy” 1.9 TDI me vit të prodhimit 1996, me nr. të shasisë: WFOGWWPSWGTR26919, me taraga të regjistrimit RKS *targat regjistrimit...*, bashkë me lejen e qarkullimit të Serbisë CP089873.. dhe leja e qarkullimit të Republikës së Kosovës CRA 03051... Këtë urdhër obligohen që ta zbatojnë Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit sendin e tillë ta administrojë sipas ligjit në fuqi.
 - b. Të pandehurit D.F. i konfiskohet lejen e qarkullimit të Serbisë CP074794..
4. Obligohen të pandehurit, në mënyrë solidare, që t’i paguajnë shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj, secili veç e veç, shumë prej 30€, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
5. Pala e dëmtuar, Dogana e Kosovës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.1557/2015 të datës 01.06.2016, kundër të pandehurëve: I. Z.M. dhe R.C., për shkak të veprës penale: Legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 403 par.1 e lidhur me nenin 31 të

KPRK-së, dhe II.Z.M. dhe D.F. për shkak të veprës penale: Legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 403 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, me datë 02.09.2019, ashtu që në këtë seancë të pandehurit e kanë pranuar fajësinë në tërësi sipas aktakuzës.

I pandehuri Z.M. ka deklaruar se pranoj fajësinë për këtë veprë penale, ndihem thellësishtë i penduar për atë që ka ndodhur, ky është rasti i vetëm, i premtoj gjykatës që nuk do të përsëris këto vepra në të ardhmen, andaj e lus Gjykatën që t'i merr parasysh rrethanat familjare se jam i vetmi i punësuar në familje, jemi pesë anëtarë të familjes, fakti që ka kaluar një kohë e gjatë që atëherë dhe se nuk do të përsëris më, andaj të shqiptoj një dënim sa më të butë.

I pandehurit D.F. ka deklaruar se e pranoj fajësinë për këtë veprë penale, ndihem thellësishtë i penduar për atë që ka ndodhur, është rasti i vetëm, i premtoj gjykatës që nuk do të përsërisë në të ardhmen, e lus Gjykatën që ti merr parasysh rrethanat personale se jetoj vetëm me fëmijët të moshë 13 dhe 16 vjeç dhe me nënën time çka duhet të përkujdesem për ta, faktin se jetoj nga të ardhurat e ulëta rreth 90 euro në muaj dhe këto ti merr si rrethana lehtësuese.

I pandehuri R.C. ka deklaruar se e pranoj fajësinë për këtë veprë penale, jam thellësishtë i penduar për atë që ka ndodhur, i premtoj gjykatës që nuk do të ndodhë në të ardhmen, është ky rasti i vetëm, e lus Gjykatën që ti merr parasysh rrethanat personale se jemi gjashtë anëtarë të familjës ku vetëm unë punoj, dhe faktin se nuk kam rënë më herët ndesh me ligjin.

Prokurori, lidhur me pranimin e fajësisë deklaroi: i propozoj Gjykatës që në bazë të nenit 248 par.2 të KPP-së duke pasur parasysh pranimin e fajësisë nga të pandehurit konsideroj se janë plotësuar kushtet ligjore nga par.1 i nenit 248, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe i propozoj gjykatës që të pranoj këtë pranim të fajësisë sepse pranimi është bazuar në provat materiale të cilat gjenden në aktakuzë dhe me rastin caktimit dhe llojit dhe lartësisë së dënimit këtë pranim ta merr si rrethanë lehtësuese. .

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e kanë deklaruar të pandehurit: Z.M., D.F. dhe R.C., në mbështetje të nenit 248 të KPP-së, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurit. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurve, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: Raporti policor me numër të referencës 2015-BI-172 i datës 16.10.2015; Deklarata e të pandehurit Z.M. e dhënë në polici e datës 15.09.2015; Deklarata e të pandehurit D.F. e dhënë në polici e datës 01.09.2015; Deklarata e të pandehurit R.C. e dhënë në polici me datë 16.09.2015; Deklarata e dëshmitarit A.C. e dhënë në polici e datës 16.09.2015; Lista e gjërave të konfiskuara e datës 16.10.2015; Kontrata mbi shit-blerjen e automjetit "Ford Galaxy" 1.9 "TDI" e datës 18.01.2012; Kontrata mbi shit-blerjen e automjetit "Ford Galaxy" 1.9 e datës 20.01.2012; Raporti i ekspertizës së dokumenteve i datës 06.03.2014; çertifikatën mbi konfirmimin e rregullsisë teknike të automjetit e datës 18.01.2012; Formulari i transferit të automjetit të datës 18.01.2013. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimit të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se të pandehurit i kanë kryer veprat penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurve është bërë në mënyrë vullnetare, se të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke iu tërhequr vërejtja të pandehurve se pas pranimit të fajësisë, ata nuk mund të bëjnë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket lartësisë së dënimit,

Gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga të pandehurit.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të pandehurve dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se të pandehurit në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale: Legalizimi i përmbajtjes së rreme nga neni 403 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, e për të cilën veprën penale është paraparë dënimi me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 73 të KPK-ës. Si rrethana rënduese ka gjetur mënyrën e kryerjes së veprës penale, gjë që nga provat rezulton se të pandehurit këtë veprë e kishin kryer me dashje, mënyrën e veprimit të kryerjes së veprës penale, ashtu që të njëjtit kishin veprua në bashkëkryerje, çka tregon vendosmërin e tyre për t'i kryer këto vepra penale.

Ndërsa, si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, faktin se të njëjtit kanë shpreh keqardhje dhe janë penduar për ndodhjen e rastit, duke premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisin sjelljet e njëjta, sjelljen korrekte të pandehurve në gjykatë, kohën e kryerjes së këtyre veprave penale, e që është vitit 2012 dhe që nga atëherë ka kaluar një kohë relativisht e gjatë, më shumë se 7 vite, rrethanat personale të kryerësve që rezulton të jenë të gjendjes së dobët ekonomike, që të tre janë mbajtës të familjes, ndërsa për të pandehurin D.F. faktin se përveç që është i papunë, i njëjti ka edhe dy fëmijë dhe nënën për të cilin duhet të kujdeset.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me burg të kushtëzuar ndaj të pandehurve është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurve. Po ashtu, Gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 par 1 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata si në dispozitiv të Aktgjykimi ndaj të pandehurit R.C. e ka shqiptuar edhe dënimin plotësues – marrjen e sendit, dhe atë: Automjeti i markës “Ford Galaxy” 1.9 TDI me vit të prodhimit 1996, me taraga të regjistrimit RKS *targat e regjistrimit...*, bashkë me lejen e qarkullimit të Serbisë CP089873.. dhe leja e qarkullimit të Republikës së Kosovës CRA 03051.., si dhe ndaj të pandehurit D.F., konfiskimin e lejes së qarkullimit të Serbisë CP074794.., duke marrë për bazë sigurinë juridike. Gjykata, konsideron se ka bazë për konfiskimin e këtyre sendeve, sepse nga provat që përmban kjo lëndë penale dhe pranimi i fajësisë vërtetohet se këto sende – automjeti ishte rezultat i kryerjes së veprës penale si në aktakuzë, e cila e për të cilën veprën penale janë shpallur fajtor, ashtuqë ky automjet ishte regjistruar duke përdorur dokumente të falsifikuar. Andaj, në kuptim të nenit 69 të KPRK, i cili përcakton se sendet e përdorura apo të destinuar për kryerjen e veprës penale apo sendet të cilat janë rezultat i kryerjes së veprës penale do të konfiskohen, andaj për shkak të këtyre konstatimeve gjykata ka vendosur si në dispozitiv të Aktgjykimit që sendet e përdorura të merren - konfiskohen, për shkak edhe të konstatimeve të cekura më lartë, në të kundërtën do të legalizohen veprimet e paligjshme të ndërmarrura mbi këto sende dhe rezultatet e këtij sendi, si nën dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05\L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil, në kuptim të nenit 463 të KPP-ës.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 463 të KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.445/2016, datë 12.09.2019
2019:147113, 12.09.2019

Procesmbajtësja
Selvije Kostërci

Gjyqtari

Rrahman BEQIRI

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.